

**TABELA PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE NË FUNKSION TË HARTIMIT TË
RAPORTIT PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK**

Emërtimi i ligjit	Ligji është subjekt i konsultimit publik	Koordinatori për konsultimin publik	Forma e njoftimit	Palët e përfshira në konsultim	Forma e konsultimit (marrja e komenteve dhe rekomandimeve)	Afati i dorëzimit të komenteve dhe rekomandimeve	A ka patur zgjatje/përsëritje	Shqyrtimi i komenteve dhe rekomandimeve	Raporti për transparencë në procesin e vendimarrjes	Shqyrtimi i ankesave, nëse ka
“Per kadastrën”	Po	Periand Teta	Regjistri i Konsultimit të Njoftimeve Publike	Qytetarë	Regjistri i Konsultimit të Njoftimeve Publike	28.11.2018	Jo	Nuk ka komente	-	-
			Regjistri i Konsultimit të Njoftimeve Publike	Shkolla e Magjistraturës Fakulteti i Drejtësisë ATP ZRPP Avokatë	Tryeza e Rrumbullakët	11.11.2018	Jo	Sipas procesverbalit bashkëlidhur këtij informacioni	-	-
“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, në Republikën e Shqipërisë”	Po	Periand Teta	Regjistri i Konsultimit të Njoftimeve Publike	Qytetarë	Regjistri i Konsultimit të Njoftimeve Publike	28.11.2018	Jo	Nuk ka komente	-	-
			Regjistri i Konsultimit të Njoftimeve Publike	Shkolla e Magjistraturës Fakulteti i Drejtësisë ATP ZRPP Avokatë	Tryeza e Rrumbullakët	11.11.2018	Jo	Sipas procesverbalit bashkëlidhur këtij informacioni	-	-



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

TRYEZË E RRUMBULLAKËT

MBI KONSULTIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR KADASTRËN” DHE “PËR PËRFUNDIMIN E PROCESEVE KALIMTARE TË PRONËSISË, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në datën 11.11.2018 në ambientet e ministrisë së Drejtësisë u organizua tryeza e rrumbullakët me objekt diskutimi mbi projektligjin “Për Kadastrën” dhe Projektligjin “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” me përfaqësues të Shkollës së Magjistraturës, Fakultetit të Drejtësisë, Agjencisë së Trajtimit të Pronës, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ALUIZNI dhe të tjerë.

Duke qenë përpara një prezantimi të parë të projektligjeve, nga ana e përfaqësuesve të grupit të punës të ngritur me Urdhrin e Kryeministrit nr. 201, datë 21.11.2017, si dhe nivelit të njohjes paraprake nga ana e pjesëmarrësve, u paraqitën disa komente të karakterit parimor, të cilat u mbajtën në konsideratë, si dhe u vlerësuan nga grupi i punës mbi reflektimin e tyre në përmbajtjen e projektakteve. Në mënyrë të përmbledhur komentet konsistuan në:

1. Për strukturën e posaçme për shqyrtimin e animimeve në ASHK, të merret për analogji parashikime të ngjashme si në ISSH, të cilat shqyrtojnë ankimet administrative dhe vendimet e tyre cilësohen *quasi gjyqësor*. Struktura e posaçme e shqyrtimit të ankimeve të jetë në nivel apelimi *quasi gjyqësor* që shqyrtimi dhe vendimmarrja e tyre të jetë pothuajse si një vendim gjyqësor;
2. Në ligjin për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH, të shihet mundësia e përcaktimit të afateve konkrete për përfundimin e disa prej proceseve të përfshira në të.
3. Stafi i ASHK-së (*përveç personave që do kenë kontakte me publikun*) që do shqyrtojë praktikën e ndryshme për çdo parashikim të ligjit, të jetë shumë i përgatitur profesionalisht dhe me sfond jo të korruptueshëm, si dhe të shikohet mundësia të vinë nga shkolla e magjistraturës.
4. Të shihet mundësia që gjykata e Apelit të mos gjykojë si shkallë e parë, duke qenë se me ndryshimet e reja të legjislacionit procedural edhe Gjykata e Lartë ka ndryshime për mënyrën e vendimmarrjes, por kjo nisur edhe nga fakti që numri i kërkesë padive do jetë i madh në numër.

5. Sugjerohet që projektligji(et) të jenë ezaurues në parashikimet e tyre, si dhe të shpjegojnë dhe përmbajnë detaje mbi parashikimet edhe sikur të jetë më shumë nene, sesa në formë deklarative këto dispozita.
6. Në aspektin e teknikës legjislativë, sugjerohet që aktet nënligjore të parashikojnë zgjidhje në aspektin teknik dhe procedural ndërsa ligji të jetë më i shtjelluar dhe ezaurues. Në një interpretim dhe konflikt ligjor në të ardhmen të prevalojnë parashikimet ezauruese në ligj sesa aktet nënligjore.
7. ASHK mos të shqyrtojë vendimet gjyqësore të formës së prerë, si dhe mbi shqyrtimin në rastet e mbivendosjeve meqenëse është parashikuar të pranohet i pari që ka kryer regjistrimin (*por që në thelb të tij mund të jetë jo i ligjshëm*) të shikohet mundësia që të dytë e me radhë t'i vihen në dispozicion dokumentet e të parit si regjistrim dhe gjykata të vendosë se kujt i takon kjo pronë.
8. Të shihet mundësia e heqjes së konceptit (*apo diçka e ngjashme*) të certifikatës së pronësisë nisur edhe nga fakti që është psikologjike, por është kartela që i ka të gjitha të dhënat.
9. Të saktësohen terma si “përmirësim” në togfjalëshin përmirësim/përditësim dhe të shihet mundësia të bëhet saktësim/përditësim. Meqenëse është parashikuar si dispozitë e veçantë servituti të shihet mundësia edhe e parashikimeve mbi enfiteozën. Te parashikimi i regjistrimit të kontratave të shitjes të shihet mundësia edhe e shtimit të parashikimit për kontratën paraprake të shitjes. Në nenin 46, të draftligjit për kadastrën të shtohet parashikimi edhe për heqjen dorë nga e drejta e pronësisë, si dhe te parashikimi për enfiteozën sugjerohet të përfshihet me nenin për qiratë mbi 9 vjet, apo uzufrukti të shtohet tek neni për servitutin, si dhe renta vjetore.

Tiranë më 11.11.2018